

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EOLIC ENERGY” SH.P.K

Sot, me 13 / 10 / 2020 (dymije e njezet), ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ortaket themelues te shoqerise, kane vendosur themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin “EOLIC ENERGY” shpk.

Ortaku i vetem i shoqerise eshte

z. Rais Petrela, shtetas shqiptar, lindur me 10.04.1987, ne Tirane dhe banues ne Tirane madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit te identifikimit n. I70410075F;

Neni 1: Objekti i veprimtarise

Shoqeria ka per objekt veprimtarite e meposhtme:

- Prodhimi energjise elektrike duke shfrytezuar burimet e energjise te cilat gjenden ne natyre dhe jane te rinovueshme, Eolike, Fotovoltaike, Hidrike dhe Gjeotermale.
- Projektimi dhe Zbatimi, Studimi i Termo Centraleve apo/dhe Impianteve te cilat bejne te mundur shfrytezimin e energjise qe gjenden ne natyre dhe qe jane te rinovueshme, si dhe i Nenstacioneve e Linjave te Transmetimit TU & TL.
- Ndertimi, Projektimi, Menaxhimi, Mirembajtje dhe Operimi ne fushen e Termocentraleve apo/dhe Impianteve te cilat shfrytezojne energjinee rinovueshme.
- Shitja e energjise elektrike klienteve apo / dhe blerja e energjise elektrike nga operatore te ndryshem privat apo shteteror brenda dhe jashte vendit.
- Transmetimi i energjise elektrike ne sistemin e tensionit te larte, funksion i cili perfshin transmetimin ose interkonjeksionin nderkombetar.
- Perdorimin e sistemeve te linjave, strukturave mbeshtetese dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese per transmetimin e energjise elektrike.
- Operator i sistemit te transmetimit per te kryer aktivitetin e transmetimit te energjise elektrike dhe te dispegerimit (axhustim ose rregullimi i prodhimit te energjise elektrike sipas kerkesave te konsumit, ne nivel kombetar.
- Shperndarjen, transportin e energjise elektrike ne sistemet shperndarese te tensionit, te mesem dhe te ulet, duke patur parasysh shperndarjen deri tek konsumatori i fundit.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike Eolike, fotovoltaike, hidrike, gjeotermale dhe biomasës dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licensave të cilat mundësojnë zhvillimin e ketij aktiviteti tregtar ne menyre te qete dhe në perputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë.

Shoqeria ka te drejtë te ushtrojë çdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji në perputhje me rregullat e dispozitat ligjore ne fuqi. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse te lëshuara nga organet kompetente te fushes.



Neni 2: Kohëzgjatja

Kohezgjatja e Shoqërisë Tregtare “EOLIC ENERGY” sh.p.k fillon me regjistrimin e saj ne Qendrën kombëtare te regjistrimit dhe do te vazhdoje per nje periudhe te pakufizuar.

Neni 3: Selia, hapësira në internet dhe adresa elektronike

1. Shoqëria e ka selinë ligjore te regjistruar në adresën: **Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr.31, Qendra e Biznesit Hekla, Kati III-te, Tirane, Shqiperi.**

2. Shoqëria mund të zhvillojë veprimtarinë e saj ekonomike në të gjithë territorin e Shqipërisë si edhe jashtë saj duke hapur degë dhe/ose zyra përfaqësimi, filiale, agjenci etj. në qendra të tjera administrative në përputhje me legjislacionin e vendeve në të cilat ato hapen.

KAPITULLI II

Kapitali dhe kuotat

Neni 4: Shumat dhe pagesat e kapitalit themeltar

Kapitali i shoqërisë është 1000 Lekë (nje mije). Kapitali i shoqërisë ndahet në 1 (nje) kuote te zotëruar nga ortaku i vetem si ne vijim:

Z. Rais Petrela, zoteron 1 kuote, te barabarte me 100% të pjesëmarrjes në kapitalin të shoqërisë;

Neni 5: Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 6: Modalitete te perfitimit dhe transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



Neni 7: Kalimi i kuotave me kontratë

(1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe vetëm me akt noterial dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratorët. Kalimi i kuotës i njoftohet shoqërisë në seline e saj ligjore.

(2) Në rastin e transferimit me akt midis të gjalleve, rezervohet në favor të ortakeve të tjere e drejta e parablerjes.

Për këtë qëllim ortaku që ka ndërmend të shesë teresisht ose pjesërisht kuotat e tij duhet të njoftojë me anë të letres rekomandë ortaket e tjere, duke saktësuar çmimin dhe modalitete të tjera të shitjes.

Ortakët e tjere mund të behen blerës të kuotave të ofruara në proporcion me kuotat e shoqërisë të zoteruara nga ata.

Brenda tridhjetë nga komunikimi i bërë nga ortaku që ka ndërmend të shesë kuotat e tij, ortaket e tjere duhet të komunikojnë nëse kanë ndërmend të ushtrojnë të drejtën e parablerjes.

Pasi ka skaduar ky afat dhe asnjë ortak nuk ka kërkuar blerjen e kuotave, e drejta e parablerjes do të quhet e ezauruar.

Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, transferimi tek të tretet jo ortake është sidoqoftë i varur nga miratimi i ortakeve të tjere;

Në hipotezën e mospelqimit, atëherë kur nuk tregohet emri i blerësit tjetër me kushte të njëjta, ortaku ka të drejtën e terheqjes.

Shoqëria mban, nën kujdesin e administratoreve, me të njëjtat modalitete të vendosura nga ligji për librat e tjere të shoqërisë, librin e ortakeve, në të cilin duhet të tregohen emri dhe adresa e ortakeve, pjesëmarrja që i perket secilit, derdhjet e bera për kuotat, ndryshimet në personat ortake, si edhe, kur njoftohet, adresa e tyre e telefaksit dhe posta elektronike, për qëllimet e vendosura nga ky statut.

Transferimi i pjesëmarrjes dhe krijimi i të drejtave reale mbi to kanë efekt ndaj shoqërisë që nga momenti i regjistrimit në librin e ortakeve, që do të kryhen nën kujdesin e administratoreve pas depozitimit në regjistrin e shoqërive sipas ligjit.

(3) Asambleja e ortakeve me vendim të kualifikuar mund të mos pranojë që administratorët/i të regjistrojnë kalimin e kuotës pranë QKB-së nëse kuota objekt i shitjes nuk ka qenë shlyer tërësisht në kapitalin e shoqërisë.

(4) Nëse Asambleja nuk pranon të regjistrohet kalimi i kuotës, administratorët/i brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë blerësit njoftimin për mospranimin.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE


Neni 8: Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;



- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9: Thirrja e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10: Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë, personalisht ose me ane te prokures, ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 1/2 (nje te dyten) e numrit total te votave (me shume se 50% e kapitalit te shoqerise).

Per sa i perket mbledhjeve qe kërkojnë shumicë të kualifikuar te asamblese sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 1/2 (nje e dyta) e ortakeve qe kane te drejte vote janë të pranishëm (pra eshte e pranishme me shume se 50% e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise), votojne me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11: Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me me shume se ¾ e votave te ortakeve te pranishem, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,

shpërndarjen e fitimeve, emrimin dhe shkarkimin e administratorit, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshte te votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - c) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12: Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kapitulli IV Administratoret

Neni 13: Emerimi i administratoreve


(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14: Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Ne pergjithesi administratori i shoqërisë do të ketë të drejte dhe kompetence të realizojë të gjitha veprimet për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 2 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 2 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15: Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;


c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja



e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 16: Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17: Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

Neni 18: Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;



d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19: Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20: Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21: Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EOLIC ENERGY” shpk



RAIS PETRELA